



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 97 prot.

Kamëz, më 26.07.2024

V E N D I M
Nr. 74 .Datë 26.07 2024
M B I

**“MIRATIMIN E KRIJIMIT TË ANSAMBLIT TË VALLEVE “ARTAN CUKU”,
KRIJIMIT TE FORMACIONIT ORKESTRAL DHE PAGESËS SË TYRE NËPËRMJET
HONORAREVE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.07.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.51 Datë 19.07.2024 Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”; VKB-së nr. 103, datë 18.12.2023 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2024, 2025, 2026” i ndryshuar, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e krijimit të Ansamblit të Valleve “Artan Cuku” me përbërje prej 15 (pesëmbëdhjetë) çiftesh, të cilët do të performojnë në aktivitete që organizon Bashkia Kamëz, nëpërmjet Drejtorisë së Qendrës së Kulturës.
 - 1.1 Secilit valltar do t’i lidhet një Kontratë Pune me Honorar me afat 1 (një) vit.
 - 1.2 Pagesa do të jetë kundrejt shumës 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo shfaqje që valltari merr pjesë.
 - 1.3 Fondi është planifikuar në buxhetin e vitit 2024 në strukturën buxhetore Gr.0 , Kap. 5, Prog. 08220 Llog. 602.
2. Miratimin e dhënies së honorareve për grupin e Formacionit Orkestral, të cilët do të performojnë në aktivitetet që organizon Bashkia Kamëz, nëpërmjet Drejtorisë së Qendrës së Kulturës.
 - 2.1 Secilit instrumentist do t’i lidhet një Akt-Marrëveshje për shërbimin e ofruar, në kuadër të aktivitetit pjesëmarrës.
 - 2.2 Instrumentisti do të paguhet në shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për çdo shfaqje që merr pjesë.
 - 2.3 Fondi është planifikuar në buxhetin e vitit 2024 në strukturën buxhetore Gr.0 , Kap. 5, Prog. 08220 Llog. 602.
3. Shfuqizimin e Vendimit nr. 7, datë 17.01.2022, i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Për zbatimin e sa më sipër do të ngarkohen Drejtoria e Qendrës së Kulturës dhe Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**



KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI